



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:128360
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05486381

P.nr.71/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Lulzim Paçarizi me sekretaren juridike Behije Karaçica, në lëndën penale kundër të akuzuarit R. K. nga fshati B.komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par. 1 të KPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës PP.II.nr.1833/21 të datës 13.06.2021, në shqyrtimi fillestar të mbajtur më datë 19.03.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit Anton Hsanaj, të akuzuarit R. K., mbrojtësit të tij Av. Agron Kryeziu me autorizim, si dhe i dëmtuari F. Z., me dt. 20.03.2024, merr ndërsa me dt. 21.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: R. K. nga i ati O. dhe e ëma S. e lindur K., i lindur me datë ... në fshatin B. komuna e Malishevës, ku edhe jeton, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i R. Të Kosovës, i martuar, i ati i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me datën 05.12.2021 rreth orës 18:05, në fsh. S. K. Malishevë, me dashje dhe atë përmes telefonit seriozisht e kanos zyrtarin policor të dëmtuarin – F.Z.se do ti shkaktojë ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose shkaktimit të ankthit, në atë mënyrë që ditën kritike gjatë një pike kontrole, zyrtari policor se bashku me kolegët e tij, ndalojë për kontrole rutinore veturën e tipit ËV T. me traga regjistrimi ..., të cilën ishte duke e drejtuar personi D. B., ku gjatë kontrollimit të dokumentacionit rezultoi se vetura prone e te pandehurit nuk kishte sigurim, me pas të njëjtit i shqiptohet tiketa për kundërvajtje, me ç'rast me të marr këtë informacion i pandehurit përmes telefonit të tij e thërret të dëmtuarin dhe pasi sigurohet se i njëjti i kishte shqiptuar tiktetën ne ato momente e kanos te dëmtuarin me fjalët “*Degjo mir ti F., nga sot e tutje ti ki me pas punë privatisht me mua*”, ku si pasojë tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë për jetën dhe sigurinë e tij.

- Me çka ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 7, 17, 21, 38, 39, 43, 44, 69, 70, 181 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, nenit 230, 364, 449 par.1 dhe 2 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës të njëjtin e:

G J Y K O N

Me dënimin me burgim, në kohëzgjatje prej **4 (katër)** muajve, me kërkesën dhe pëlqimin e mbrojtësit të akuzuarit av. Agron Kryeziu dhe të akuzuarit, konform nenit 44 lidhur me nenin 43 të KPRK-së, dënimin me burgim prej 4 (katër) muajve, **I ZËVËNDESOHET ME DËNIMIN ME GJOBË** në shumën prej **700 €** (shtatëqind) euro, të cilën shumë i akuzuari është i detyruar ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro), dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzet euro) të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë- Departamenti i përgjithshëm me dt. 13.06.2023 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1833/21, kundër të akuzuarit R.K.nga fsh. B. K. Malishevë, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 181 par.3 lidhur me par. I të KPRK-së, dhe se bashku me aktakuzë kanë paraqitur edhe marrëveshjen e pranimit të fajësisë PP.nr.1833/21 të dt. 08.06.2023, të arritur ndërmjet prokurorit të shtetit në njërën anë si dhe të pandehurit R. K. me mbrojtësin e tij av. Agron Kryeziu me autorizim në anën tjetër.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimit të fajësisë me datën 19.03.2024, ku kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Anton Hasanaj, i akuzuari R. K. dhe mbrojtësi i tij av. Agron Kryeziu me autorizim, kështu gjyqtari e ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tij, ashtu siç e parasheh edhe neni 230 të KPP-së.

I akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar udhëzimet në konsultim me mbrojtësin, dhe se pajtohet me këtë marrëveshje për pranimit të fajësisë

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj ka theksuar se: Pranë kësaj gjykate është sjellë marrëveshja e arritur midis prokurorisë së shtetit dhe këtu të akuzuarit R. K.në prezencë të mbrojtësit të tij Av. Agron Kryeziu nga Malisheva, sipas marrëveshjes PP.nr. 1833/21, e dt.08.06.2023, për të cilën marrëveshje për kushtet e llojin e dënimit është e njoftuar kjo gjykatë si dhe vet i akuzuari i cili është palë në këtë marrëveshje. Andaj, përveç kushteve të caktuara në këtë marrëveshje ne si prokurori nuk kemi çka të shtojmë dhe i propozon gjykatës që kjo marrëveshje të aprovohet dhe të jetë pjesë e shkresave të lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. K., Av. Agron Kryeziu ka deklaruar: Konfirmojmë se me dt. 08.06.2023, unë bashkë me klientin tim jemi paraqitur në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, për të realizuar takimin fillestar lidhur me diskutimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, dhe ne te njëjtën ditë bashkë me prokurorin e çështjes Kastriot Memaj, si dhe Kryeprokurorit në Gjakovë kemi arritur marrëveshje për të cilën paraprkishtë unë dhe i mbrojturi im morëm kohën e mjaftueshëm për këshillim, sqarim të drejtave dhe obligimeve dhe pasi që jam bindur se ajo çfarë shkruan në marrëveshje është vullnet i të mbrojturit tim i cili derivon pas konsultave të mjaftueshme dhe plotësohen të gjitha kushtet ligjore, kemi lidhë këtë marrëveshje të cilën e pranojmë në tërësi. Kemi lenë një hapësirë që do ta vërej gjykata tek dënimi që gjykatës ti drejtohem me kërkesë që maksimalisht të pranohet kufiri i parë i gjobës së dakorduar dhe këto rrethana i kemi sqaruar edhe tek prokurori i çështjes dhe eprori i sajë. Nën prezumimin se gjykata do na lejoj edhe njëherë ti adresohemi për këtë çështje pas vendimit për pranim apo jo të marrëveshjes rezervojmë të drejtën që edhe një herë ti drejtohem gjykatës për të shpalosur rrethanat personale me rëndësi për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Përfundimisht kjo është marrëveshja që ne e kemi dakorduar dhe ne rast se pranohet nga gjykata heqim dorë që të njëjtën ta kontestojmë për çfarë shkak apo arsye.

Gjykata pasi shqyrtoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe pasi konstatoi se nuk ka ndonjë pengesë ligjore për aprovimin e saj, ka nxjerrë aktvendim me të cilën e ka aprovuar këtë marrëveshje për pranim të fajësisë PP.II.nr. 1833/21 të datës 08.06.2023, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjorë për një gjë të tillë konform 230 të KPP-së. Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se i akuzuari i kupton natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë rrethanë të parapara në nenin 253 par. 1 dhe 2 të KPP-së. Gjithashtu gjykata ka vlerësuar se palët e kësaj marrëveshje për pranimin e fajësisë kanë hequr dorë nga shqyrtimi gjyqësor për t'u shqyrtuar kjo çështje juridike penale, si dhe të gjitha të drejtat tjera lidhur me shqyrtimin gjyqësor dhe i kanë propozuar gjykatës për aprovim të saj.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë; Raporti i policit M. B. #... dt. 05.12.2021, deklarata e të dëmtuarit F. Z. e dhënë në Polici me dt. 05.12.2021, fletëparaqitja për Kundërvajtje e dt. 05.12.2021, alkool testi i dt. 05.12.2021 i bërë të pandehurit R. K., lista e thirrjes e nxjerr nga telefoni i të dëmtuarit, deklarata e dëshmitarit H. K. e dhënë në Polici me dt. 07.12.2021, deklarata e dëshmitarit H.H. e dhënë në Polici me dt. 08.12.2021, deklarata e të pandehurit R. K. e dhënë në Prokurori me dt.08.06.2023, si dhe shkresat tjera në lëndë.

Nga veprimet e të akuzuarit, përmbushën të gjitha elementet e veprës penale të kanosjes nga neni 181 par.3 lidhur me par. 1 Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për të cilin i akuzuari u shpall fajtor dhe i'u shqiptua dënimi sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar dhe ka aprovuar rekomandimin për dënimin të paraqitur me marrëveshjen për pranimin e fajësisë ndaj të akuzuarit dhe të shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve, ndërsa me kërkesën e mbrojtjes dhe të akuzuarit dënimi me burg i zëvendësohet me dënimin me gjobë shumë prej 700 € (shtatëqind) duke e konsideruar si dënim të drejtë dhe duke vlerësuar shkallen e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarin pati parasysh rrethanat e nenit 69 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin vlerësoj faktin se ka arritur marrëveshje për pranim të fajësisë, gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen do të këtë kujdes dhe nuk do të përsërisë vepra të tilla, është penduar për këtë veprë penale, se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, është i gjendjes së dobët ekonomike, mban familjen prej 5 nataresh me punë në sektorin privat në ndërtimtari dhe atë me punë sezonale, gjithashtu gjyqtari vetëm gjykues vlerëson se me shqiptimin e dënimit sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi, do të arrihet edhe qëllimi i dënimit për veprën penale të kanosjes nga neni 181 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, me bindje se ky dënim është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojnë që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

I dëmtuari F. Z. nuk është udhëzuar në kontestin civil, pasi që i njëjti nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.71/23, me dt.20.03.2024.

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.